

Informata mbi ndihmën materiale dhe rikthimin e familjeve me fëmijë të mitur, të mirëpritur, nën Aktvendimin Mbretëror të 24 qershor 2004

Qka është ndihma materiale në favor të familjeve me të mitur, me qëndrim ilegal?

Prej 2004 ligji parasheh një ndihmë të posaqme për familjet me fëmijë të mitur të cilët jetojnë ilegalisht në Belgjikë. Kjo ndihmë **ipet vetëm në qendrat e mirëpritjes** të hapur të menaxhuar nga Ofiçaria e të Huajve, nën konventën për bashkëpunim me Fedasil-in.

Eshtë një ndihmë e posaqme e cila quhet “ndihmë materiale” dhe nënkupton **strehim në qendër të mirëpritjes kolektive**, që gjatë qëndrimit tuaj do të ju mundësohet një shoqërim social dhe mjekësor, një ndihmë për rikthimin në vendin tuaj vullnetarisht, dhe poashtu ngrënie dhe para për shpenzime.

Cilat janë kushtet për marrjen e kësaj ndihme materiale?

Për të përfituar një ndihmë materiale, duhet plotësuar **katër** kushte:

- Fëmiju është **nën moshën 18 vjet**
- Fëmiju dhe prindërit (ose tjerë të riturr përgjegjës për fëmijun) jetojnë **ilegalisht** në Belgjikë.
- **Lidhja prindërore** ose **autoriteti prindëror** egziston.
- **Fëmiju është nevojtar** sepse prindërit ose ata që kanë autoritet prindëror, nuk e plotësojnë ose nuk kanë mundësi plotësimin e mirëmbajtjes së fëmijut.

Si duhet bërë një kërkesë për ndihmë materiale ?

- Kërkesa duhet bërë në CPAS të komunës **ku ju banoni**.

Roli i CPAS-it është kryesisht pranimi i kërkesës, informimi i arsyes dhe veqoritë e ndihmës materiale, si dhe verifikimi për të parë nëse te gjitha kushtet për këtë ndihmë janë të plotësuara.

Kur fëmiju plotëson kushtet për të marrë këtë ndihmë materiale, ai dhe familja e vetë orientohen në një qendër për mirëpritje. Në asnjë mënyrë ju nuk mundeni të paraqiteni drejtpërsëdrejti në një qendër për mirëpritje.

Si duhet vepruar pas një propozimi për strehim të Fedasil-it ?

Kur CPAS-i merr një vendim efektiv për një strehim nga Fedasil-i si dhe terminin të Shpërndarësi, ai ju kërkon **të pranoni me shkrim** propozimin për strehim në një qendër të mirëpritjes.

CPAS-i ju dorëzon **një kopje të dokumentit** me të cilin keni pranuar me shkrim propozimin për strehim. Me atë dokument dhe ftesën për tu lajmëruar në Shërbimin e Shpërndarjes, fëmiju dhe familja e tij duhen të lajmërohen në ditën e caktuar.

Ju keni drejt të **mos pranoni** këtë propozim me shkrim. Ky mospranim me nënshkrim mund të quhet si mospranim për strehim.

Si ta kuptoni në cilën qendër ndihma materiale do tu ipet ?

Nëse keni pranuar propozimin për strehim të Fedasil-it, duhet të paraqiteni në Shërbimin e Shpërndarjes të Fedasil-it **prej ditës së caktuar** në dokumentin e dhënë nga CPAS-i dhe më së voni brenda 30 ditë.

Me arritjen e juaj në Shërbimin e Shpërndarjes, do të ju komunikohet emri dhe adresa e qendrës në të cilën ju dhe fëmijë/fëmijët do të strehoeni.

Tash e tutje, ndihma materiale ipet vetëm në qendër të hapur për rikthim, e menaxhuar nga Ofiqaria e të Huajve në përputhje me konventën për bashkëpunim me Fedasil-in. Në këtë qendër të hapur do të keni përcjellje për rikthim vullnetar gjatë periudhës deri në kohën kur ju duhet të largoheni nga territori. Ju mund të mos pranoni qendrën që ju propozojnë, por kjo nënkupton që ju hiqni dorë nga ndihma materiale.

Prandaj, nëse mëpastaj ju megjithatë dëshironi një vend në një qendër të mirëpritjes, duhet bërë një kërkesë të re pranë CPAS-it të komunës ku banoni.

Vërrejtje: ju duhet të prezantoheni në Shërbimin e Shpërndarjes me gjithë anëtarët e familjes që kanë drejt në ndihmën materiale, bashkë me fëmijët e mitur, si dhe vendimin e CPAS-it, ftesën e Shërbimit të Shpërndarjes, dhe poashtu kopjen e propozimit për strehim.

Si zhvillohet udhëtimi i rikthimit?

Në kohën e arritjes suaj në qendër për rikthim, këshillëtari i rikthimit dhe këshillëtari i Ofiqarisë e të Huajve ju informojnë mbi udhëtimin e rikthimit të propozuar në kuadër të ndihmës material dhënë familjeve me fëmijë të mitur me qëndrim ilegal. Nëse është nevoja, një përkthyes do të jetë i pranishëm për të siguruar një kuptim të plotë të informatave që ju ipen.

Informatat mbi udhëtimin e rikthimit janë të udhëzuara në një document të nënshkruar nga secili I rritur I familjes. Ky document nënkupton:

- Njohuritë e udhëtimit dhe pasojat nga familja,
- Zotimin e Ofiqarisë e të Huajve për mosmarrje të masave për largimin e familjës gjatë udhëtimit,
- Zotimin e Fedasil-it për mirëpritje dhe shoqërim

Një skedë njejësimi duhet plotësuar dhe nënshkruar nga secili I rritur I familjës.

Procedurat e kërkesave për qëndrim në vazhdim do të shqyrtohen me përparësi nga shërbimet e Ofiqarisë e të Huajve, dhe ju do informoheni së shpejti mbi mundësitë për rikthim vullnetar.

Rikthimi vullnetar duhet bërë brenda afatit të urdhërit për të lëshuar territorin. Në rast force madhore dhe jo e varrur nga vullneti juaj, ju mund ta zgjatni këtë afat me një kërkesë të motivuar pranë Ofiqarisë e të Huajve.

Qka ndodhë nëse udhëtimi I rikthimit dështon?

Pas afatit të urdhërit për të lëshuar territorin, nëse nuk keni marr një vendim pozitiv të kërkesës për autorizim qëndrimi dhe asnjë zotim me shkrim për rikthim vullnetar nuk është bërë, Ofiqaria e të Huajve merr masa për largimin tuaj me forcë. Në këtë rast ju nuk mundeni të qëndroni tutje në qendër të hapur për rikthim.

Kur përfundon mirëpritja e juaj në qendër?

- Kur të merrni një leje qëndrimi ;
- Kur të ktheheni në vendin tuaj vullnetarisht;
- Kur të mbarteni në një shtëpi rikthimi e menaxhuar nga Ofiqaria e të Huajve për largimin tuaj;
- Kur ta lëshoni qendrën e mirëpritjes.